



**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET
E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT
DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME DHE FINANCËS**

**SHPLLJE PËR NËPUNËS CIVIL,
LËVIZJE PARALELE
PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE**

**Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit (AIDSSH)
Drejtorja e Verifikimit të Figurave**

Në zbatim të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe pranimit në shërbimin civil **1 (një) vend** vakant në pozicionin:

- Specialist, Drejtorja e Verifikimit të Figurave
- Kategoria e pagës IV-1

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit nga jashtë shërbimit civil.

**Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim nga jashtë shërbimit civil
mund të aplikohet në të njëjtën kohë)**

Afati për dorëzimin e dokumentave për: LËVIZJE PARALELE	4.8.2024
Afati për dorëzimin e dokumentave për: PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL	9.8.2024

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

- Bazuar në sistemet, procedurat dhe rregullat e qarta dhe të sigurta të organizimit, funksionimit, koordinimit të punës në Drejtorinë e Verifikimit të Figurave dhe në bashkëpunim me, Drejtorinë e Arkivit, dhe sektorët e tjerë:
 - përpunon kërkesat e institucioneve kushtetuese, autoriteteve publike dhe subjekteve të tjera institucionale;
 - bashkëpunon me sektorët e tjerë për nxjerrjen dhe përpunimin e informacionit për qëllime informimi sipas kërkesave të institucioneve kushtetuese dhe autoriteteve publike, kur kjo kërkohet në kuadër të vlerësimit, të cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve për t'u emëruar ose ngritur në detyrë sipas pozicioneve të parashikuara në ligjin nr. 45/2015;
 - informon, u krijon mundësi dhe lehtësi aksesit tek dokumentet, institucioneve kushtetuese, autoriteteve publike dhe kandidatëve për tu zgjedhur;
 - përgatit me shkrim përgjigjet për çdo kërkesë të paraqitur nga kandidatët për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, kryetarë bashkish dhe kryetarë këshilli qarku, në lidhje me ekzistencën për ta të informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të shtetit, kur kjo kërkohet për qëllime të transparencës së figurës, gjatë fushatave elektorale, bazuar tek modelet e miratuara nga Autoriteti;
 - përgatit me shkrim përgjigjet e kërkesave për Institucionet dhe Autoritetet e tjera bazuar tek modelet e miratuara nga Autoriteti.
 - plotëson bazën e të dhënave dhe prodhon mbi bazën e kërkesave raporte statistikore në lidhje me kërkesat për informim nga institucionet;
 - ndihmon dhe bashkërendon punën me strukturat e tjera të institucionit lidhur me hulumtimin dhe studimin e dosjeve që lidhen me ish-funksionarë të aparatit shtetëror të kohës të regjimit komunist të viteve 1944-1991, mbajtës të funksioneve politike/në aparatin shtetëror, rolit të tyre gjatë ushtrimit të funksioneve, për të mbështetur aktivitetet që realizon Autoriteti në kuadër të njohjes së të shkuarës komuniste.
- Në zbatim dhe përputhje me legjislacionin përkatës dhe rregullores të brendshme, ndjek zbatimin nga ana e sektorit, të sistemeve, procedurave dhe rregullave në lidhje me aktivitetin e Drejtorisë përsa i përket:
 - mbrojtjes të të dhënave të evidentuara gjatë aktivitetit të Drejtorisë që mund të përbëjnë apo mund të klasifikohen si sekret shtetëror;
 - mbrojtjes të të dhënave personale të evidentuara gjatë aktivitetit të Drejtorisë përsa i përket marrëdhënieve dhe informimin e medias të shkruar, elektronike apo audio vizuale
- Kryen detyra të tjera sipas kërkesave të eprorëve.

1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori.
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- c- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Bachelor” në shkencat shoqërore preferohet në fushën historike, juridike. Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master” në shkencat shoqërore të të njëjtës fushë. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- b) Të kenë jo më pak se 1 vit eksperiencë pune.
- c) Të kenë njohuri të gjuhës angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë Dokumentet si më poshtë:

- a- Kërkesë për të konkuruar në pozicionin e shpallur në procedurën përkatëse;
- b- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
- c- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore (jo më të vjetër se 1 muaj);
- g- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- h- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- i- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- j- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Kandidatët që aplikojnë duhet të plotësojnë gjithashtu kushtet e parashikuara në pikën 3 të nenit 12 të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës **4.8.2024, në Zyrën e Arkiv-Protokollit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-**

Sigurimit të Shtetit me adresë: Njësia Administrative nr. 4, Rruga e Dibrës, Garnizoni “Skënderbej”, Tiranë.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Jo më vonë se data **06.8.2024**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhenë portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e lëvizjes paralele do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, për shkaqet e moskualifikimit(nëpërmjet adresës së e-mail).

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me njohuritë mbi:

- a) Ligjin Nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të RPSSH”; i ndryshuar;
- b) Ligjin Nr.9154 “Për Arkivat”, dhe normat tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor;
- c) Ligjin Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, i ndryshuar;
- d) Ligjin Nr. 9887, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
- e) Ligjin Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij;
- f) Ligjin Nr. 9131, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- g) Ligjin Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
- h) Ligjin Nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”;
- i) VKM Nr.502, datë 23.6.2010 “Për miratimin e rregullores “Për transportimin fizik të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror””;
- j) VKM Nr. 662, datë 17.11.2017,, “Për deklasifikimin e zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, që ndodhet në rrjetin kombëtar të arkivave”;

- k) VKM Nr.190, datë 4.3.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr. 81, date 28.01.2008, te Këshillit te Ministrave, "për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për asgjësimin e informacionit te klasifikuar "sekret shtetëror"";
- l) VKM Nr. 542, datë 25.7.2019 "Për Miratimin e Rregullores "Për sigurinë e Informacionit të klasifikuar që trajtohet në sistemet e komunikimit dhe të Informacionit (SKI)";

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me Dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, "Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedures së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur", të Departamentit të Administratës Publike <http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

1.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit do të shpallë fituesin në portalin "Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive". Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

2- Pranimi në shërbimin civil

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimi në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimi në shërbimin civil janë:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) Të zotërojnë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- e) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- f) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- g) Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Bachelor” në shkencat shoqërore preferohet në fushën historike, juridike. Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master” në shkencat shoqërore të njëjtës fushë. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- b) Të kenë jo më pak se 1 vit eksperiencë pune.
- c) Të kenë njohuri të gjuhës angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.

2.2

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a- Kërkesë për të konkuruar në pozicionin e shpallur në procedurën përkatëse;
- b- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>

- c- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton njohuritë në gjuhën e huaj, trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- f- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- g- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore (jo më të vjetër se 1 muaj);
- h- Vërtetim nga punëdhënësi ose vetëdeklarim që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës **9.8.2024, në Zyrën e Arkiv-Protokollit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit me adresë: Njësia Administrative nr. 4, Rruga e Dibrës, Garnizoni “Skënderbej”, Tiranë.**

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Jo më vonë se data **23.8.2024**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit në shërbimn civil, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e pranimit në shërbimn civil do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, për shkaqet e moskualifikimit(nëpërmjet adresës së e-mail).

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Ligjin Nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të RPSSH”; i ndryshuar;
- b) Ligjin Nr.9154 “Për Arkivat”, dhe normat tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor;
- c) Ligjin Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, i ndryshuar;
- d) Ligjin Nr. 9887, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
- e) Ligjin Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij;
- f) Ligjin Nr. 9131, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;

- g) Ligjin Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
- h) Ligjin Nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”;
- i) VKM Nr.502, datë 23.6.2010 “Për miratimin e rregullores “Për transportimin fizik te informacionit te klasifikuar "sekret shtetëror"”;
- j) VKM Nr. 662, date 17.11.2017,, “Për deklasifikimin e zhvlerësimin e informacionit te klasifikuar "sekret shtetëror", qe ndodhet ne rrjetin kombëtar te arkivave”;
- k) VKM Nr.190, datë 4.3.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr. 81, date 28.01.2008, te Këshillit te Ministrave, "për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për asgjësimin e informacionit te klasifikuar "sekret shtetëror"”;
- l) VKM Nr. 542, datë 25.7.2019 “Për Miratimin e Rregullores “Për sigurinë e Informacionit të klasifikuar që trajtohet në sistemet e komunikimit dhe të Informacionit (SKI) ”;

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a - Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b - Intervistën e strukturuar me gojë qe konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c - Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “ëëë.dap.gov.al”

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

2.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit do të shpallë fituesin në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe

Aftësive”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.